

20192754299

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT
PËR SIGURIM PENSIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 180/19), në nenin 37 pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

“(4) Në rast kur ka rritje të rrogës minimale në vitin rrjedhës për më shumë se 15% dhe rritje të rrogës mesatare në vitin paraprak për më shumë se 5%, krahas harmonizimeve të përmendura në paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, mund të kryhet harmonizim plotësues të pensioneve në përqindje jo më të lartë se rritja e rrogës mesatare në vitin paraprak.

(5) Shumën dhe mënyrën e harmonizimit plotësues të pensioneve nga paragrafi (4) të këtij neni me vendim i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.”.

Neni 2

Në nenin 221 në paragrafin (1) fjalët: “3.000 euro ” zëvendësohen me fjalët: “1000 deri 2000 euro”.

Në paragrafin (2) fjalët: “300 deri 400 euro” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 200 euro”.

Në paragrafin (3) fjalët: “3.000 euro në kundërvlerë me denarë” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë për mikro tregtarë, prej 500 deri 700 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të vegjël, prej 700 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të mesëm dhe prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin (4) fjalët: “300 deri 400 euro” zëvendësohen me fjalët: “150 deri 250 euro”.

Në paragrafin (5) fjalët: “3.000 euro në kundërvlerë me denarë” zëvendësohen me fjalët: “100 deri 200 euro në kundërvlerë me denarë për mikro tregtarë, prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të vegjël, prej 400 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të mesëm dhe prej 600 deri 800 euro në kundërvlerë me denarë për tregtarë të mëdhenj”.

Në paragrafin (6) fjalët: “30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik nga paragrafi (3) i këtij neni” zëvendësohen me fjalët: “300 deri 500 euro në kundërvlerë me denarë”.

Në paragrafin (7) fjalët: “300 deri 400 euro” zëvendësohen me fjalët: “150 deri 250 euro”.

Në paragrafin (8) fjalët: “300 deri 400 euro” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 300 euro”.

Neni 3

Në nenin 223 paragrafi (1) fjalët: “300 deri 400 euro ” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 300 euro”.

Neni 4

Dispozitat e nenit 187 paragrafi (1) pika 7 të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor do të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për akciza* (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 108/19, 143/19 и 225/19).

Neni 5

Ky ligj hynë në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.